



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Nr.ref.: 2058/23

Datë: 25/08/2023

Bazuar në vendimin e Senatit nr. 1603/23 të datës 19.06.2023, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), shpallë

KONKURS PËR STUDIME MASTER
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve Master për vitin akademik
2023/2024

1. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) për studimet master, në afatin e dytë të konkursit për vitin akademik 2023/24, do të regjistrojë **57** studentë të rregullt.
2. Bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI, Universiteti do të regjistrojë deri në 12% të numrit të përgjithshëm të studentëve për pranim në vitin akademik 2023/24, përkatësisht deri **12** studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci, Medvegja deri 1%, përkatësisht **3** studentë, 1% përkatësisht **3** studentë nga Maqedonia e Veriut, 1% përkatësisht **3** studentë nga Shqipëria, dhe 1%, përkatësisht deri **3** kandidatë nga Mali i Zi. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa studimet i kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'i nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim sikurse kandidatët nga Kosova.

I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT

1. Në studimet master, në UShAF, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës, në të gjitha Institucionet e Akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet themelore – Bachelor në UShAF.
2. Të drejtë pranimi në UShAF kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë, të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës.
3. Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në fushat e studimit të përafërta në fakultetet, përkatësisht programet si në vijim:
 - **Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi: Arkitekturë e Gjelbër dhe Dizajni i Interierit
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Arkitekturë; Dizajn; Përpunim i Drurit; Inxhinieri e Ndërtimit dhe në fushat e përafërta.

- **Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës**
Programi: Inxhinieria dhe Menaxhimi i Prodhimit
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Inxhinieri Mekanike; Inxhinieri Elektrike dhe në fushat e përafërta.
 - **Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit**
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm
 - Fushat e studimeve bachelor (themelore): Menaxhment i Hotelerisë dhe Turizmit; Ekonomi; Menaxhment dhe të përafërta.
4. Kandidatët, të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UShAF, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UShAF pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u ç'regjistruar nga programi aktual i studimeve.
 5. Kandidatët për pranim si studentë në UShAF, në vitin akademik 2023/24 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se në një fakultet apo program të studimit.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve, për të gjitha fakultetet, do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
 Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë dhe atë:
 - Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;
 - Pikët nga lëndët prioritare (5 lëndë) deri në 50 pikë.
2. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatët tjerë, jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të lëndëve prioritare, e nëse edhe pikët e lëndëve prioritare janë të njëjta, atëherë do të mirret parasysh suksesi i studimeve themelore Bachelor. Nëse edhe suksesi është i njëjtë, përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femrore. Në qoftëse kandidatët i takojnë gjinisë së njëjtë, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.
3. Për funksionimin e programit studimor të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 10 studentëve.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi online fillon nga data **31.08.2023** dhe zgjatë deri më **07.09.2023** në ora **16.00**.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **31.08.2023**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora 10.00.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **31.08.2023** deri më datën **07.09.2023** (dokumentet do të pranohen çdo ditë, me përjashtim të të dielave). Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës.
4. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen e plotësuar, e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: linku për aplikim online përmes internetit është www.ushaf.net/apliko
- Ekstraktin e lindjes (origjinal), jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Diplomën ose çertifikatën e diplomimit të studimeve bachelor-themelore orgjinale ose të noterizuar;
- Çertifikatën e notave nga studimet bachelor-themelore orgjinale ose të noterizuar;
- Dëshminë e akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë;
- Vendimin e nostrifikimit, të cilin duhet ta sjellin kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor-themelore jashtë vendit;

Konform Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 09/2021 të MASHTI, kandidatët që aplikojnë për studimet master, lirohen nga pagesa për aplikim.

5. **Shpallja e rrezultateve preliminare bëhet më së voni deri më 08.09.2023, ndërsa rezultatet përfundimtare shpallen më 12.09.2023 në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqen e Universitetit.**

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët, të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master, mund të ankohen kundër vendimit pas shpalljes së rezultateve preliminar, përkatësisht në datën **11.09.2023** nga ora **8:00 - 16:00** në Administratën Qendrore. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave.

Kandidatët, të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Administratën Qendrore të UShAF me datë **19.09.2023**.

V. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit me datë **13.09.2023** dhe **14.09.2023**.
2. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
3. Kandidatët, të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më **18.09.2023** deri në ora **16.00**. Jashtë këtij afati, kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, dhe e humbin të drejtën e regjistrimit.
4. Nëse kandidati i pranuar nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
5. Vendet e mbetura vakante, pas humbjes së të drejtës së regjistrimit, përkatësisht lëshimit të afatit, do të zëvendësohen me kandidatët të cilët janë të ranguar në listë si të pa pranuar, duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.
6. Nëse vendet e rezervuara për komunitetet joshumicë dhe për shqiptarët jashtë Kosovës nuk do të plotësohen, atëherë vendet e tyre do të zëvendësohen me kandidatët e ranguar në listë si të pa pranuar, duke filluar nga numrat e parë të listës së kandidatëve jashtë pranimit.

VI. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- Fletëregjistrimin të plotësuar (i cili shkarkohet nga SMU);
- Dy fotografi të formatit 6x4 cm;

Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët duhet t'i drejtohen Administratës Qendrore ose të hapin faqen e internetit www.ushaf.net

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve master në këtë afat të konkursit do të regjistrojë **57** studentë në fakultetet si në vijim:

	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Kandidatë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvexha	Kandidatë nga Shqipëria	Kandidatë nga Maqedonia e Veriut	Kandidatë nga Mali i Zi	Gjithsej
Programi		12%	1%	1%	1%	1%	
Gjithsej	33	12	3	3	3	3	57
Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit	8	3	1	1	1	1	15
Programi: Arkitekturë e Gjellbër dhe Dizajni i Interierit	8	3	1	1	1	1	15
Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës	14	4	1	1	1	1	22
Programi: Inxhinieria dhe Menaxhimi i prodhimit	14	4	1	1	1	1	22
Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	11	5	1	1	1	1	20
Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në turizëm	11	5	1	1	1	1	20
Totali	33	12	3	3	3	3	57

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas notës mesatare në studimet themelore dhe lëndëve prioritare sipas programeve në vijim:

Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit

Programi: Arkitektura e Gjellbër dhe Dizajni i Interierit

1. Cad;
2. Bazat e Dizajnit;
3. Dizajni i Interierit;

4. Dizajni i Mobileve;
5. Materialet me Bazë Druri.

Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës

Programi: Inxhinieria dhe Menaxhimi i Prodhimit

1. Matematikë;
2. Programim;
3. Teknologjia e Përpunimit të Materialeve Polimere;
4. CAD;
5. Materialet Inxhinierike.

Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit

Programi: Menaxhimi dhe Inovacioni në Turizëm

1. Bazat e Ekonomisë;
2. Bazat e Kontabilitetit;
3. Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri;
4. Bazat e Turizmit;
5. Turizmi i Qëndrueshëm.